



Department
of Health &
Social Care

Ta bëjmë vaksinimin kusht për shpërndarjen në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit

Publikuar në 14 prill 2021

Programi i vaksinimit COVID-19

1. Programi i vaksinimit COVID-19 është programi më i madh i vaksinimit në historinë e NHS-së. Që nga data 7 prill 2021, pothuajse 27 milionë njerëz kanë marrë dozën e parë të vaksinës COVID-19 në Angli [\[shënim i fundfaqes 1\]](#). Të gjithë njerëzve që jetojnë në shtëpitë e kujdesit, personelit, punonjësve të shëndetit dhe të kujdesit social, personave 50 vjeç e lart, dhe personave jashtëzakonisht të prekshëm nga ana klinike, u është ofruar një vaksinë. Këto grupe përbëjnë 99% të vdekjeve nga COVID-19, që do të thotë se, me gjasë, do të shpëtohen mijëra jetë. Analiza e kryer nga Public Health England (Shëndeti Publik i Anglisë) sugjeron që programi i vaksinimit COVID-19 parandaloi 6100 vdekje në Angli deri në fund të shkurtit 2021. Vaksinat [COVID-19 janë miratuar nga MHRA-ja](#) si të sigurta dhe efektive në zvogëlimin e gjasave të infektimit me COVID-19 dhe parandalimin e sëmundjeve të rënda tek ata që infektohen me virusin.

2. Ka [prova që sugjerojnë se vakcina parandalon gjithashtu që ata që marrin virusin të infektojnë dhe të tjerë](#), duke parandaluar përhapjen. Studimi SIREN siguron prova të forta se vaksinimi i të rriturve në moshë pune do të zvogëlojë ndjeshëm infeksionin asimptomatik dhe simptomatik të SARS-CoV-2 duke zvogëluar në këtë mënyrë transmetimin e infeksionit në popullatë. [Ky studim ka treguar një efektivitet kundër infeksionit](#) prej 72% (95% CI nga 58 në 86) 21 ditë pas dozës së parë të Pfizer-it - kjo është e ngjashme me efektet që shihen në provat e AstraZeneca-s. Ndikimi në transmetim pritet të jetë së paku kaq i madh. Mbrojtja ndaj transmetimit mund të jetë pak më e vogël tek të moshuarit, të bjerë me kalimin e kohës ose të jetë më vogël ndaj varianteve specifike.

3. Është thelbësore që të bëjmë gjithçka që mundemi për të mbrojtur njerëzit që janë më të rrezikuar nga sëmundja serioze prej COVID-19 dhe e dimë se vaksinimi është kyç për rrugëzgjdhjen nga kjo pandemi. Kemi bërë një rrugë të gjatë, por ka ende më shumë për të bërë.

Marrja e vaksinimit në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit

4. Ne nuk dëshirojmë kurrë që të kthehemi në pozitën e epidemive të përhapura në shtëpitë e kujdesit në të cilat shumë njerëz që jetojnë e punojnë në ato shtëpi të kujdesit humbën jetën. Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) identifikoi njerëzit që jetojnë në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personelin e tyre si [grupin me përparësinë më të madhe për ta marrë vaksinën të parët](#).

5. Grupi i Punës i Kujdesit Social të Grupit të Pavarur Këshillimor Shkencor për Emergjencat (SAGE) ka theksuar se njerëzit që jetojnë në shtëpitë e kujdesit janë ndikuar ndjeshëm nga pandemia e COVID-19 për shkak të një kombinimi të rrezikut të rritur të rezultateve të rënda pas infektimit me COVID-19 dhe rrezikut të epidemive në këto mjedise të mbyllura. Sigurimi i niveleve shumë të larta të vaksinimit të njerëzve që jetojnë dhe punojnë në këto mjedise është një ndërhyrje thelbësore e shëndetit publik për një sëmundje serioze të parandalueshme nga vaksina. Mjediset me të njëjtin grup njerëzish që krijojnë kontakt të ngushtë me njëri-tjetrin shumë herë në ditë do të bëjnë të mundur transmetim më të shpejtë dhe më gjithëpërfshirës të virusit tek të gjithë pronësuesit (punonjësit dhe banorët) sesa mjediset e tjera më të hapura.

6. Grupi i Punës i Kujdesit Social të SAGE-s ka këshilluar që do të nevojitet një normë e marrjes së vaksinës prej 80% nga personeli dhe 90% nga banorët në secilin mjedis individual të shtëpisë së kujdesit për të siguruar një nivel minimal të mbrojtjes kundër epidemive të COVID-19. Kjo është për një dozë të vetme kundër variantit aktual dominues. Këto përqindje mund të jenë më të ulëta pas një doze të dytë, por shfaqja e varianteve të reja mund t'i rritë këto nivele, kështu që vlerësimet e nivelit minimal të mbulimit mund të ndryshojnë.

7. Nisja e vaksinimit ndaj COVID-19 së pari në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit ka qenë mbresëlënëse falë udhëheqjes në të gjithë NHS-në, sektorit të kujdesit social dhe qeverisë lokale. Që nga data 4 prill 2021, 94.1% e të gjithë njerëzve të kualifikuar që jetojnë në shtëpitë për të moshuarit në Angli kanë marrë të paktën vaksinimin e tyre të parë. Që nga data 4 prill 2021, 78.9% e të gjithë punonjësve të kualifikuar në të gjitha shtëpitë e kujdesit për të moshuarit kishin bërë gjithashtu të paktën vaksinimin e tyre të parë. Ndërsa normat e marrjes së vaksinimit po rriten ngadalë nga java në javë, shifra e përgjithshme prej 78.9% për personelin fsheh ndryshime të konsiderueshme në nivelin e shtëpive së kujdesit rajonale, lokale dhe individuale. Që nga data 8 prill 2021, 89 autoritete lokale kanë një normë vaksinimi personeli nën 80%, duke përfshirë të 32 njësitë administrative të Londrës. 27 autoritete lokale kanë një normë vaksinimi të personelit nën 70%.

8. Si pasojë, ka ende një numër të madh të shtëpive të kujdesit për të moshuarit të cilat nuk po arrijnë ende nivelin e duhur të mbrojtjes siç këshillohet nga SAGE për të zvogëluar rrezikun e epidemisë. Prandaj, mbetet një rast i fortë për futjen e një kërkesë të re në mënyrë që mjediset me rrezik shumë të madh të bëhen sa më të sigurta nga efektet shkatërruese të COVID-19.

Çfarë ka bërë qeveria për të inkurajuar vaksinimin

9. Në 13 shkurt 2021, ne publikuam [Planin e dorëzimit të vaksinave COVID-19](#) të Mbretërisë së Bashkuar, duke përcaktuar programin domethënës të punës në zhvillim e sipër për të nxitur marrjen e vaksinës, duke përfshirë veprimet për të përmirësuar shfrytëzimin dhe për të trajtuar shqetësimet e atyre që mund të ngurrojnë në marrjen e vaksinës. Ne po ofrojmë gjithashtu një program të synuar të punës për të mbështetur marrjen e vaksinës midis personelit të kujdesit social për të rriturit dhe veçanërisht personelit të shtëpive të kujdesit, duke punuar me palët e interesuara kombëtare dhe lokale, duke përfshirë drejtuesit e shtëpive të kujdesit.

10. Ne kemi punuar për ta bërë vaksinimin të shfrytëzueshëm për njerëzit që jetojnë dhe punojnë në shtëpitë e kujdesit - ekipet e vaksinimit kanë vizituar drejtpërdrejt shtëpitë e kujdesit për të ofruar vaksinimin. NHS England (NHS-ja e Anglisë) po zhvillon një program minimal prej katër vizitash për çdo shtëpi të kujdesit për të moshuarit. Për ata punonjës që mund të mos kenë qenë të pranishëm kur ekipi i vaksinimit ka bërë vizitën në shtëpi, ka qenë në dispozicion shfrytëzimi përmes shërbimeve të tjera të vaksinimit. Ne hapëm gjithashtu Shërbimin Kombëtar të Rezervimit për 7 javë në mënyrë që punonjësit e kujdesit social të vijës së parë të mund të rezervonin takimet e tyre. Nga data 1 prill, punonjësit e shtëpive të kujdesit mund të organizojnë vaksinimin drejtpërdrejt përmes mjekut të tyre të përgjithshëm.

11. Në mënyrë që të trajtojmë çdo pyetje dhe shqetësim midis punonjësve të shtëpive të kujdesit (dhe fuqisë më të gjerë të punës së kujdesit social për të rriturit), ne kemi ofruar një program të gjerë komunikimi. Ai përfshin:

- materiale komunikimi të përshtatura (afishe, video, fletëpalosje dhe burime të bashkëndara të medieve sociale) të shpërndara në aplikacionin tonë CARE, buletin informativ të përjavshëm dhe kujdesin social për të rriturit dhe kanalet sociale të Departamentit të Shëndetit dhe Kujdesit Social
- një fushatë reklamuese të paguar që ka për objektiv punonjësit e kujdesit social me reklama dixhitale për të krijuar besimin te vaksina dhe për të inkurajuar rezervimet në Shërbimin Kombëtar të Rezervimit
- një paketë mjetesh për palët e interesuara (pyetje dhe përgjigje, materiale udhëzuese dhe komunikuese) e cila përditësohet çdo javë
- mesazhe pozitive duke përdorur personat me influencë, udhëheqësit dhe punonjësit e shtëpive të kujdesit të cilët tashmë janë vaksinuar për të rritur besimin dhe për të trajtuar dezinformimin
- përmbajtje në gjuhë të ndryshme dhe përmbledhje me grupe të ndryshme besimi të cilët kanë shprehur interes në bashkë-krijimin e përmbajtjes së vaksinës dhe duke vepruar si ambasadorë

12. Ne vazhdojmë të punojmë me palët e interesuara për të identifikuar veprimet e mëtejshme në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar për të rritur marrjen e vaksinës. Si pjesë e kësaj, ne synojmë mbështetjen për shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, ku marrja e vaksinës është e ulët, si p.sh. në Londër. Që nga data [4 prill 2021, marrja e vaksinës midis punonjësve të kualifikuar në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit](#) në Londër është 67.8%, krahasuar me 82.4% në South West. E gjitha është e integruar

nga puna në nivel lokal, nga punëdhënësit, autoritetet lokale, ekipet e shëndetit publik dhe të tjerët.

13. Pavarësisht nga këto përpjekje, marrja e vaksinës midis punonjësve të shtëpive të kujdesit nuk është vazhdimisht në nivelin që dimë nga këshillat e SAGE-s janë të nevojshme për të minimizuar rrezikun e epidemisë. Është e domosdoshme që tani të ndërmerim së bashku çdo hap të nevojshëm për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së virusit tek ata që janë më të rrezikuar nga COVID-19 dhe ata që kujdesen për ta. Ne duhet të mbrojmë njerëzit që jetojnë në shtëpitë e kujdesit dhe fuqinë punëtore që kryen një rol kaq të rëndësishëm. Vaksinimi është një mënyrë e sigurt dhe efektive për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Është e drejtë që qeveria të veprojë tani për të siguruar që ata që angazhohen në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit të vaksinohen për të mbrojtur çdokënd në këto mjedise.

Qëllimi i politikës

14. Ne po propozojmë të ndryshojmë rregulloret për të kërkuar që ofruesit e shtëpive të kujdesit për të moshuarit të angazhojnë vetëm ata punonjës që kanë marrë vaksinimin e tyre COVID-19 në përputhje me udhëzimet e qeverisë. Kjo nuk do të përfshijë ata që mund të japin prova për përjashtimin mjekësor nga vaksinimi ndaj COVID-19. Gjithashtu, ne synojmë të ndryshojmë Kodin e Praktikës për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve për të shpjeguar kërkesën. Ne po konsultohemi për këtë politikë dhe nëse duhet të shtrihet për të përfshirë profesionistë të tjerë që bëjnë vizita në shtëpinë e kujdesit, për shembull punonjësit e NHS-së që ofrojnë kujdes të ngushtë personal për njerëzit që jetojnë në shtëpinë e kujdesit.

15. Ekzistojnë shumë mjedise të tjera në të gjithë kujdesin social dhe shëndetësor për të rriturit ku për njerëzit më të rrezikuar nga COVID-19 ofrohet kujdes në mjedise të mbyllura me rrezik të madh. Ne do ta mbajmë këtë politikë në shqyrtim të vazhdueshëm dhe do të marrim parasysh nëse në kohën e duhur është e nevojshme që politika të shtrihet në pjesë të tjera të sektorëve të kujdesit social dhe shëndetësor për të rriturit.

Propozimi për ndryshim legjislativ

16. Ne po planifikojmë që ta vëmë në zbatim këtë politikë përmes një ndryshimi në [Rregulloren e vitit 2014 për Aktin për Shëndetin dhe Kujdesin Social të vitit 2008 \(Aktivitetet e rregulluara\)](#). Ne propozojmë që ta futim kërkesën si një dispozitë të re në standardet themelore në Pjesën 3 të Rregullores, me shumë gjasa në rregulloren 12 (e cila merret me kujdesin dhe trajtimin e sigurt) si një shtesë të rregullores 12(2)(h), e cila kërkon që, si pjesë e sigurimit të kujdesit dhe trajtimit të sigurt, ofruesit duhet të vlerësojnë rrezikun dhe të parandalojnë, zbulojnë dhe kontrollojnë përhapjen e infeksioneve, duke përfshirë ato që lidhen me kujdesin shëndetësor. Ne do të ndryshojmë gjithashtu [Kodin e Praktikës për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve](#) dhe udhëzimet e tij shoqëruese, i cili botohet nga Sekretari i Shtetit sipas nenit 21 të Aktit për Shëndetin dhe Kujdesin Social të vitit 2008 dhe të cilin ofruesit duhet ta kenë parasysh kur respektojnë detyrimet e tyre sipas rregullores 12 të Rregullores.

Paralelisht me këtë konsultim, janë publikuar projekt-ndryshimet në Kodin e Praktikës (shikoni [Shtojcën A](#)).

17. Për shkak të rëndësisë së kësaj çështjeje, ne synojmë ta ndryshojmë shpejt ligjin. Është qëllimi ynë aktual që punonjësve në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit t'u kërkohet që ta mbajnë të përditësuar statusin e tyre të vaksinimit ndaj COVID-19. Kjo do të mbahet nën shqyrtim.

Si ndiheni në lidhje me kërkesën e propozuar që punonjësit në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit të bëjnë një vaksinim COVID-19?

- E mbështes
- E mbështes deri diku
- As e mbështes, as nuk e mbështes
- Nuk e mbështes shumë
- Nuk e mbështes
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Jepni detaje për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Shtëpitë e kujdesit për të moshuarit

18. Rregulloret e propozuara do të zbatoheshin për çdo shtëpi të kujdesit që ka të paktën një person mbi moshën 65 vjeç që jeton në shtëpinë e tij në Angli dhe i cili është i regjistruar në Komisionin e Cilësisë së Kujdesit. Vlerësohet se ka afërsisht 10.000 shtëpi të kujdesit.

A jeni dakord me përdorimin e këtij përkufizimi për të përcaktuar se për cilat shtëpi të kujdesit do të zbatohet kjo rregullore?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Çfarë shqetësimesh keni në lidhje me këtë përkufizim?

19. Grupi i Punës i Kujdesit Social SAGE ka këshilluar që është e arsyeshme të vazhdohet me shtëpitë e kujdesit për të moshuarit si një mjedis ku kërkesa për vaksinim mund të jetë e përshtatshme. Shtëpitë e kujdesit për të moshuarit kanë një

popullsi me një moshë mesatare mbi 80 vjeç, me shumë sëmundje bashkëshoqëruese. Disa njerëz që jetojnë në shtëpitë e kujdesit mund të kenë demencë dhe probleme neurologjike e të sjelljes të cilat dëmtojnë aftësinë e tyre për të ndjekur praktikatat e kontrollit të infeksionit. Në këto mjedise të mbyllura, punonjësit mund të ofrojnë kujdes ose të kenë kontakte të rëndësishme me banorë të shumtë, si dhe me punonjës të tjerë. Ky nivel i ndërveprimit mund të çojë në transmetim efektiv të COVID-19 (dhe sëmundjeve të tjera infektive) me rezultate të rënda për disa njerëz. Vlerësimet aktuale të raportit të vdekshmërisë së rasteve janë rreth 20% - pothuajse dyfishi i atyre të moshave të ngjashme jashtë mjediseve të shtëpive të kujdesit. Pritet që vaksinimi të zbusë ndjeshëm rezultatet e rënda.

A keni ndonjë shqetësim në lidhje me propozimin për të kufizuar këtë politikë në shtëpitë e kujdesit për të më të moshuarit më të vjetër?

- Po
- Jo
- Nuk e di

Shpjegoni përgjigjen tuaj.

Personat që kanë nevojë për vaksinim

20. Synimi ynë është që kërkesa për t'u vaksinuar të zbatohet për të gjithë personelin e angazhuar në një shtëpi të kujdesit që mbështet të paktën një të moshuar mbi 65 vjeç. Kjo do të sigurojë që mbulimi i vaksinimit të mbrojë punonjësit individualë dhe njerëzit që jetojnë në shtëpitë e kujdesit dhe të mbrojë nga rreziku i epidemive në shtëpinë e kujdesit. Kjo është në përputhje me këshillat e Grupit të Punës së Kujdesit Social SAGE.

21. Kjo do të përfshinte të gjithë punonjësit e punësuar drejtpërdrejt nga shtëpia e kujdesit ose ofruesin e shtëpisë së kujdesit (me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme), të punësuarit nga një agjenci dhe të angazhuar nga shtëpia e kujdesit dhe vullnetarët e angazhuar në shtëpinë e kujdesit. Do të përfshinte ata që ofrojnë kujdes të drejtpërdrejtë dhe ata që punojnë në shtëpitë e kujdesit duke kryer role të tjera, të tilla si pastruesit dhe personelin e kuzhinës. Kjo është në përputhje me qasjen tonë ndaj testimit të COVID-19 në shtëpitë e kujdesit.

22. Janë të nevojshme konsiderata të mëtejshme nëse duhet ta shtrijmë kërkesën për të përfshirë ata njerëz që vijnë në shtëpinë e kujdesit për të ofruar shërbime profesionale, ose kujdes dhe mbështetje tjetër. Me gjasa, kjo politikë duhet të shtrihet te profesionistët që bëjnë vizita, veçanërisht tek ata që ofrojnë kujdes të ngushtë personal, siç janë punonjësit e shëndetësisë dhe kujdesit. Mund të përfshijë gjithashtu floktarët ose udhëheqësit e besimit që bëjnë vizita. Po shqyrtojmë me kujdes gjithashtu situatën e “ofruesve të kujdesit thelbësor”- ata miq ose familje që kanë rënë dakord me shtëpinë e kujdesit që do të bëjnë rregullisht vizita dhe do të

ofrojnë kujdes personal. E kuptojmë se këtu ka konsiderata kyçe për gamën e njerëzve që mund të vijnë në shtëpitë e kujdesit dhe të mirëpresin pikëpamjet tuaja në pyetjet e konsultës më poshtë.

23. Nuk synojmë që ta shtrijmë këtë politikë te miqtë dhe anëtarët e familjes që u bëjnë vizita njerëzve që jetojnë në shtëpitë e kujdesit - përveç atyre që ofrojnë kujdes thelbësor, ku po shqyrtojmë me kujdes se cila qasje është më e mira. Grupi i Punës i Kujdesit Social SAGE ka këshilluar që duhet të vendoset një ekuilibër midis rrezikut që ka një person i dashur që bën vizitë dhe transmetimit të virusit, përkundër përfitimeve të mirëqenies për ata që jetojnë në një shtëpi të kujdesit. Sigurisht që do t'i inkurajonim miqtë dhe anëtarët e familjes që bëjnë vizitë në shtëpinë e kujdesit për të shfrytëzuar vaksinimin sa më parë që të munden, megjithatë, për sa kohë që vizitorët [ndjekin me kujdes këshillat në udhëzimet tona](#), nuk mendojmë se është e nevojshme që kërkesa të shtrihet te familjarët që bëjnë vizita. I mirëpresim pikëpamjet tuaja për këtë propozim në pyetjet më poshtë.

Cilët njerëz që punojnë ose bëjnë vizita në një shtëpi të kujdesit për të moshuarit duhet të përfshihen në fushën e politikës?

- Vetëm personeli me pagesë i angazhuar në shtëpinë e kujdesit
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Personeli që punon për ofruesin e shtëpisë së kujdesit që punon në një ndërtesë të veçantë, por mund të bëjë herë pas here vizita në shtëpinë e kujdesit (për shembull personeli që punon në një zyrë jashtë selisë)
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Profesionistët e shëndetit që bëjnë vizita rregullisht në shtëpinë e kujdesit dhe ofrojnë kujdes të ngushtë personal për njerëzit që jetojnë në shtëpinë e kujdesit
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Profesionistë të tjerë që ofrojnë kujdes të ngushtë personal për njerëzit që jetojnë në shtëpinë e kujdesit, për shembull, floktarët
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Të gjithë profesionistët që hyjnë në një shtëpi të kujdesit pavarësisht nga roli i tyre, për shembull, elektrikist, hidraulik, terapist artistik, terapist muzikor
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Miqtë ose anëtarët e familjes të projektuar si “kujdestarë thelbësorë” që bëjnë rregullisht vizita dhe ofrojnë kujdes të ngushtë personal
 - Po

- Jo
- Nuk kam mendim
- Të gjithë miqtë dhe familjarët që mund të bëjnë vizita
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Vullnetarët
 - Po
 - Jo
 - Nuk kam mendim
- Të tjera (specifikoni)

Përrjashtime

24. Do të ketë një numër të vogël njerëzish ku këshilla klinike është që vaksinimi ndaj COVID-19 nuk është i përshtatshëm për ta. Ne do të sigurojmë që rregulloret të lejojnë përjashtime për arsye mjekësore. Rregulloret do të hartohen në përputhje me Librin e Gjelbër për Imunizimin kundër sëmundjeve infektive ([COVID-19: libri i gjelbër, kapitulli 14a](#)) dhe Komitetin e Përbashkët të Vaksinimit dhe Imunizimit (JCVI) të cilët pasqyrojnë këshillat klinike. Individët do të përjashtohen nga kërkesa nëse kanë një alergji ose gjendje që rendit Libri i Gjelbër (Kapitulli 14a, faqja 16) si një arsye për të mos marrë një vaksinë, për shembull reaksion alergjik i mëparshëm ndaj një përbërësi të vaksinës, duke përfshirë polietilen glikolin (PEG). Disa individë kanë një alergji ose gjendje ku Libri i Gjelbër ose JCVI-ja këshillon që të kërkohen këshilla mjekësore përpara se të vazhdohet me vaksinimin, ku duhet të kërkohet mendimi profesional mjekësor nëse individ i duhet të përjashtohet. Si në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, deri më tani nuk janë identifikuar shenja shqetësuese të sigurisë në lidhje me vaksinimin e grave që janë shtatzënë. JCVI-ja po vazhdon të rishikojë të dhënat mbi rreziqet dhe përfitimet e vaksinimit për gratë që janë shtatzënë pa gjendje shëndetësore të fshehura. Ndërsa dalëngadalë provat bëhen të disponueshme, ato do të rishikohen dhe do të ofrohen këshilla sipas rastit.

25. Qeveria po shqyrton mënyrën më pak të rëndë që njerëzit t'u demonstrojnë punëdhënësve të tyre se janë të përjashtuar nga vaksinimi për shkaqe mjekësore.

26. Politika do të rishikohet nëse punonjësit e kualifikuar do të parandaloheshin nga pengesa të rëndësishme për të shfrytëzuar vaksinimin në një kohë dhe në mënyrë të arritshme, të tilla si për shkak të çështjeve të furnizimit me vaksinë ose ndryshimeve në udhëzimet klinike kombëtare. Për shembull, kjo do të nënkuptojë se nëse çështjet e furnizimit e bëjnë të pamundur që një anëtar i personelit të shfrytëzojë vaksinimin brenda një distance udhëtimi të arsyeshme, kërkesa për atë individ nuk do të zbatohet derisa të zgjidhet çështja e furnizimit.

27. Qeveria do të ndjekë [këshillat e JCVI-së](#), të cilat përcaktojnë se, si masë parandaluese, është e preferueshme që, aty ku është në dispozicion, për personat nën 30 vjeç pa gjendje mjekësore të fshehura të ofrohet një alternativë ndaj vaksinës të Oksfordit/ AstraZeneca.

A jeni dakord në lidhje me grupet e njerëzve që do të përjashtohen nga kjo kërkesë?

- Plotësisht dakord
- Prirem të jem dakord
- As jam dakord, as nuk jam dakord
- Prirem të mos jem dakord
- Aspak dakord
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Kush tjetër duhet të përjashtohet nga kjo kërkesë?

Zbatimi

28. Në fund, menaxherët e shtëpive të kujdesit janë përgjegjës për sigurinë e njerëzve që jetojnë nën kujdesin e tyre. Sipas ndryshimit të propozuar të rregulloreve, do të ishte përgjegjësia e tyre të kontrollojnë provat se punonjësit e angazhuar në shtëpi janë të vaksinuar, ose përjashtohen nga vaksinimi për arsye mjekësore. Kjo do të thotë që punonjësit do të duhet t'i sigurojnë menaxherit prova se janë vaksinuar.

29. Qeveria po shqyrton me kujdes mënyrën më të mirë që njerëzit të vërtetojnë te punëdhënësi i tyre se janë vaksinuar. Kjo mund të përfshijë, për shembull, shfaqjen e statusit të vaksinimit në një aplikacion në telefonin celular.

Këto pyetje janë specifike për drejtuesit e shtëpive të kujdesit pasi duam të kuptojmë se si do t'i përgjigjeshin drejtuesit e shtëpive të kujdesit personelit që nuk është i vaksinuar.

Personeli juaj do të duhet të jetë në gjendje të tregojë se është vaksinuar. Si do të preferonit që ta bënin këtë?

- Aplikacion celular
- Vetëdeklarim i shkruar
- Konfirmim verbal
- Nuk e di
- Të tjera (specifikoni)
- Nuk aplikohet

Kjo pyetje është specifike për personelin në shtëpitë e kujdesit në lidhje me praktikën e vërtetimit të statusit të vaksinimit.

Do t'ju duhet të jeni në gjendje të tregoni se jeni vaksinuar. Si do të preferonit ta bënit këtë?

- Aplikacion celular
- Vetëdeklarim i shkruar
- Konfirmim verbal
- Nuk e di
- Të tjera (specifikoni)
- Nuk aplikohet

Këto pyetje janë specifike për autoritetet lokale dhe partnerët e NHS-së pasi përqendrohen në aftësinë e tyre për të porositur shërbime.

A keni shqetësime në lidhje me ndikimin e kërkesës së propozuar në aftësinë tuaj për të porositur shërbime?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Çfarë shqetësimesh keni në lidhje me ndikimin e kërkesës së propozuar në aftësinë tuaj për të porositur shërbime?

30. Qeveria po shqyrton se cila do të ishte një periudhë e përshtatshme e shtyrjes së pagesës për punonjësit e rinj dhe ekzistues të shtëpive të kujdesit përpara se të kërkohet që të vaksinohen.

31. Presim që drejtuesit e shtëpive të kujdesit të mbajnë një regjistër të vaksinimeve si pjesë e të dhënave të punësimit të personelit të tyre dhe shëndetit në punë.

Sa i lehtë do të jetë zbatimi i kësaj politike për drejtuesit e shtëpive të kujdesit për të moshuarit?

- Shumë i lehtë
- Mjaft i lehtë
- As i lehtë, as i vështirë
- Mjaft i vështirë
- Shumë i vështirë
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Jepni detaje për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Roli i Komisionit të Cilësisë së Kujdesit

32. Synimi ynë është që kjo kërkesë të jetë pjesë e Standardeve Themelore (të përcaktuara në Rregulloren e vitit 2014 për Aktin për Shëndetin dhe Kujdesin Social të vitit 2008 (Aktivitetet e rregulluara) dhe të monitorohet e zbatohet në raste të përshtatshme, nga Komisioni i Cilësisë së Kujdesit (CQC). Do të ishte e vlefshme për çdo shtëpi të kujdesit që ka ndonjë person mbi moshën 65 vjeç që jeton atje. Normat e raportuara të vaksinimit do të ishin pjesë e një pakete informacioni që CQC-ja merr parasysh kur përcakton se cilat mjedise duhet të inspektohen.

33. Në kohën e regjistrimit dhe kur inspektohen, drejtuesit e shtëpive të kujdesit duhet të japin prova se punonjësit e tyre janë të përditësuar me vaksinimin e një vaksine COVID-19 të miratuar nga MHRA-ja.

34. Në rast të mosrespektimit të legjislacionit, CQC-ja do të zbatonte një qasje përpjesëtimore dhe të bazuar te rreziku, duke parë të gjitha provat e identifikuar dhe nëse është përmbushur testi i interesit publik, në përputhje me rregullat e tij për zbatimin. CQC-ja ka kompetenca të zbatimit civil dhe në rastet më rënda, mund të jetë i përshtatshëm zbatim penal kundër ofruesit ose drejtuesit të regjistruar,

35. Opsionet e zbatimit civil në dispozicion të CQC-së përfshijnë lëshimin e: një njoftimi paralajmërues, lëshimin e një njoftimi propozimi/vendimi për vendosjen, ndryshimin ose heqjen e kushteve të regjistrimit, lëshimin e një njoftimi propozimi/vendimi për pezullimin ose anulimin e regjistrimit, duke bërë një kërkesë në gjykatë për anulim të menjëhershëm të regjistrimit kur ekziston rrezik serioz për jetën, shëndetin ose mirëqenien e një personi dhe lëshimin e një njoftimi urgjent të vendimit për pezullimin ose ndryshimin e kushteve të regjistrimit kur ekziston rreziku i lëndimit të një personi.

36. Rregullorja 12 imponon një kërkesë ndaj ofruesve dhe drejtuesve të regjistruar për të siguruar kujdes dhe trajtim të sigurt. Kjo përfshin një kërkesë për ofruesin dhe drejtuesin e regjistruar për të vlerësuar rrezikun, dhe për të parandaluar, zbuluar dhe kontrolluar "përhapjen e infeksioneve, duke përfshirë ato që lidhen me kujdesin shëndetësor". Kjo plotësohet me Kodin IPC të Sekretarit të Shtetit të lëshuar nën seksionin 21 të Aktit të Kujdesit Shëndetësor dhe Social të vitit 2008. Kur një shkelje e rregullores 12 rezulton në dëm të shmangshëm ose një rrezik të konsiderueshëm të dëmit të shmangshëm për një përdorues të shërbimit, ofruesi ose drejtuesi i regjistruar mund të jetë fajtor për një vepër penale, dhe CQC-ja do të shikojë nëse do të ndër marrë veprime të zbatimit penal. Njoftimi i fiksuar për ndëshkimin më të madh është 2.000 ose 4.000 paundë, për një shkelje të kryer përkatësisht nga një drejtues ose ofrues i regjistruar.

Ndikimi dhe përfshirjet e politikës

37. Analiza jonë fillestare e Detyrës së Sektorit Publik për Barazinë (PSED) tregon se të bërit të vaksinimit kusht për shpërndarjen në shtëpitë e kujdesit për të rriturit mund të ketë një ndikim më domethënës në grupe të caktuara. Në veçanti, fuqia

punëtore e kujdesit shoqëror për të rriturit ka një përqindje të lartë grash dhe njerëzish nga komunitetet me ngjyrë të zezë, aziatike dhe pakicat etnike. Ka disa prova që sugjerojnë se këto grupe mund të jenë më ngurrues në lidhje me vaksinimin në përgjithësi dhe me vaksinën e COVID-19 në veçanti duke qenë se është një vaksinë e re. Vazhdon të ketë një program domethënës pune për të trajtuar këto shqetësime si pjesë e punës së vazhdueshme për të mbështetur vaksinimin veçanërisht brenda fuqisë punëtore të kujdesit social për të rriturit dhe popullatës së gjerë. Jemi shumë të interesuar të kuptojmë se çfarë mund të bëjmë më shumë për të siguruar që këto grupe, dhe kushdo tjetër, të mos ndikohej në mënyrë të diferencuar nga kjo politikë e re dhe si mund ta menaxhojmë këtë për të arritur ambicien tonë për të mbrojtur të gjithë ata që janë angazhuar dhe janë duke marrë mbështetje në mjediset e shtëpive të kujdesit.

A ka grupe të veçanta njerëzish, siç janë ata me karakteristika të mbrojtura, të cilët do të përfitonin në mënyrë të veçantë nga kjo politikë?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Cilat grupe të veçanta mund të ndikohen pozitivisht dhe pse?

A ka grupe të veçanta njerëzish, siç janë ata me karakteristika të mbrojtura, të cilët do të ndikoheshin në mënyrë të veçantë nga kjo politikë?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Cilat grupe të veçanta mund të ndikohen negativisht dhe pse?

Çfarë mund të bëjmë për t'u siguruar që ato nuk do të ndikohen negativisht?

38. Ne synojmë të botojmë Vlerësimin tonë të Barazisë në Sektorin Publik si pjesë e përgjigjes ndaj kësaj konsulte dhe do të gjurmojmë me kujdes ndikimin e politikës, nëse do të zbatohet, në marrjen e vaksinave.

39. Në zemër të qëllimit të kësaj politike është mbajtja e një fuqie punëtore të aftë, të dhembshur dhe të kujdesshme, siguria e fuqisë punëtore dhe e njerëzve për të cilët ata kujdesen dhe të bërit të punës në kujdesin social për të rriturit një zgjedhje karriere tërheqëse. Ne i njohim sakrificat që janë bërë për t'i bërë ballë pandemisë nga ata që punojnë në shtëpitë e kujdesit gjatë vitit të fundit. Ne besojmë se prezantimi i kësaj politike reflekton nevojën për të lëvizur me ritëm dhe me qëllim për

të shmangur rrezikun e epidemive të shmangshme në të ardhmen në shtëpitë e kujdesit. Ne do të vazhdojmë të mbështesim ofruesit e shtëpive të kujdesit dhe anëtarët individualë të personelit për të marrë vaksinën COVID-19 dhe për të mbështetur përparimin e bërë tashmë. Kjo do të përfshijë mundësinë për mbështetje 1 me 1 nga një person i besuar për ata që kanë ndonjë shqetësim në lidhje me vaksinimin dhe vazhdimin për të siguruar, përmes programit të vaksinimit të NHS-së, që shfrytëzimi i vaksinimit të jetë sa më i lehtë në mënyrë të vazhdueshme.

40. Dihet që disa njerëz mund të zgjedhin të mos vaksinohen, edhe nëse vaksinimi është klinikisht i përshtatshëm për ta. Në këto rrethana, ata nuk do të jenë më në gjendje të angazhohen në një mjedis të shtëpive të kujdesit dhe ofruesit do të duhet ta trajtojnë këtë në një mënyrë që nuk destabilizon ofrimin e një kujdesi të sigurt e me cilësi të lartë. Ne po bëjmë një pyetje në këtë konsultë në lidhje me ndikimin e mundshëm mbi nivelet e personelit, nëse punonjësit do të vendosnin që më mirë të largoheshin nga puna në shtëpinë e kujdesit sesa të vaksinoheshin. Kjo mund të jetë një çështje e veçantë në disa zona lokale ku vaksinimi është më i ulët.

Këto pyetje janë specifike për drejtuesit e shtëpive të kujdesit pasi duam të kuptojmë se si drejtuesit e shtëpive të kujdesit do t'i përgjigjeshin personelit që nuk është i vaksinuar.

Si e parashikoni se do t'i përgjigjeshit kërkesës, duke menduar për personelin që nuk është i vaksinuar?

- Angazhoni sërish personelin e pavaksinuar
- Ndaloni punësimin për personelin e pavaksinuar
- Të tjera (specifikoni)
- Nuk aplikohet

A keni ndonjë shqetësim në lidhje me ndikimin e politikës në aftësinë e shtëpive për të moshuarit për të siguruar një shërbim të sigurt?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Cilat nga këto janë shqetësime që keni në lidhje me ndikimin e politikës në aftësinë e shtëpive për të moshuarit për të siguruar një shërbim të sigurt? (shënoni të gjitha ato që aplikohen)

- Disa persona të personelit mund të refuzojnë vaksinën dhe të lënë punën e tyre aktuale

- Disa persona të personelit mund të largohen duke protestuar ndaj politikës, nëse kjo bie ndesh me bindjet e tyre personale
- Personeli i mbetur mund ndihet i fyer nga kërkesa, duke ulur moralin
- Personeli mund të kërkojë të sfidojë shtëpitë e kujdesit në gjykatë
- Ndikimi që mund të ketë në masat e tjera që prekin personelin, të tilla si zvogëlimi i lëvizjes midis mjediseve shëndetësore dhe të kujdesit
- Furnizimi i personelit alternativ të trajnuar në dispozicion
- Kostoja e mbulimit të personelit afatshkurtër
- Kostoja e rekrutimit të personelit të ri të përhershëm
- Koha që do të duhet për të rekrutuar personel të ri të përhershëm
- Të tjera (specifikoni)

Ndani këtu ndonjë dëshmi dhe mendimin tuaj në lidhje me shkallën e këtyre ndikimeve:

- Ndikimi minimal
- Ndikim mesatar
- Ndikim i rëndë

Jepni detaje për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Si mendoni se mund ta minimizojmë ndikimin e kësaj politike të re në fuqinë punëtore? (shënoni të gjitha ato që aplikohen)

- Lehtësia për të përdorur vaksinimin
- Financim specifik për të mbuluar çdo kosto që lidhet me vaksinimin, për shembull udhëtimin, kohën, kostot e efekteve anësore
- Shfrytëzimi i informacionit të përditësuar
- Mbështetje nga kampionët e vaksinimit të autoriteteve lokale
- Mbështetje nga drejtuesit klinikë të lidhur me shtëpinë e kujdesit
- Të tjera (specifikoni)

A mendoni se kjo politikë e re mund të shkaktojë ndonjë konflikt me kërkesat e tjera ligjore që shtëpitë e kujdesit duhet të plotësojnë?

- Po
- Jo
- Nuk e di
- Nuk aplikohet

Jepni detaje të mëtejshme mbi kërkesat e tjera ligjore që mund të bien ndesh me këtë politikë të re.

41. Gjatë periudhës së konsultës, ne synojmë të diskutojmë drejtpërdrejt me punëdhënësit për ndikimin e parashikuar mbi individët dhe pasojat e ligjit të punës. Nëse politika zbatohet, ne do të marrim parasysh botimin e udhëzimeve operative për drejtuesit e shtëpive të kujdesit duke përcaktuar përfshirje për drejtuesit dhe anëtarët e personelit.

Shtojca A: shtesa e propozuar në kodin e praktikës - kriteri 10

Ofruesit e regjistruar duhet të sigurojnë që ekzistojnë politika dhe procedura në lidhje me statusin e imunizimit ndaj COVID-19 të të gjithë personelit, në mënyrë që:

I gjithë personeli i kualifikuar në shtëpitë e kujdesit me një ose më shumë banorë të moshës 65 vjeç e lart të ketë bërë vaksinat COVID-19. Kjo përfshin të gjithë personelin e punësuar drejtpërdrejt nga ofruesi i shtëpisë së kujdesit, ata të punësuar nga një agjenci dhe vullnetarët e angazhuar në shtëpinë e kujdesit. Përfshin gjithashtu ata që ofrojnë kujdes të drejtpërdrejtë dhe ata që marrin role ndihmëse si pastruesit dhe personelin e kuzhinës.

Ofruesi do të demonstrojë që i gjithë personeli i kualifikuar i angazhuar në shtëpinë e kujdesit ka marrë dozat e kërkuara të një vaccine COVID-19 të miratuar nga MHRA-ja brenda periudhës së specifikuar të shtyrjes së pagesës, në përputhje me rregulloren 12, [\[shënim i fundfaqes 2\]](#) e cila mbahet në mënyrë të sigurt nga drejtuesi i regjistruar (ose personi ekuivalent) në dosjet e personelit. Kjo vlen për personelin ekzistues dhe të ri.

Ekziston një regjistër i përjashtimit mjekësor për personelin që nuk është në gjendje të marrë një vaksinë COVID-19 për arsye shëndetësore (siç përshkruhet në Librin e Gjellbër, udhëzimet e JCVI-së dhe këshillat mjekësore).

Për personelin që nuk është në gjendje të vaksinohet për arsye shëndetësore, drejtuesit e regjistruar (ose personi ekuivalent) do të kenë përfunduar vlerësimet e rreziqeve dhe do të ndërmarrin veprimet e duhura për të zbutur rreziqet.

Pranueshmëria për imunizimin e personelit rishikohet rregullisht në përputhje me Rregulloren 12.

Ekziston edukimi i duhur i personelit në lidhje me kërkesat dhe përfitimet për ta si individë dhe për njerëzit që përdorin shërbimin e tyre.

Personelit i ofrohet mbështetja e duhur për të bërë vaksinimin.

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, të gjitha të dhënat e referuara në këtë konsultë vlejné vetëm në Angli. [\[2\]](#)
2. Rregullorja e vitit 2014 për Aktin për Shëndetin dhe Kujdesin Social të vitit 2008 (Aktivitetet e rregulluara) kërkon që kujdesi dhe trajtimi të sigurohet në një mënyrë të sigurt për përdoruesit e shërbimeve. Kjo përfshin një detyrim

për personin e regjistruar për të vlerësuar rrezikun, parandalimin, zbulimin dhe kontrollimin e "përhapjes së infeksioneve, duke përfshirë ato që lidhen me kujdesin shëndetësor". Propozimi është që të ndryshohet rregullorja 12 për të përfshirë kërkesat e vaksinimit të përshkruara në këtë dokument konsultimi. CQC-ja ka fuqinë për të bërë ndjekje penale kundër një ofruesi që nuk arrin të respektojë rregulloren 12, kur ky dështim çon në dëm të shmangshëm, ose rrezik të konsiderueshëm të një dëmi të tillë. [↩](#)

□